

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 05.09.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.08.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "ULPIANA" për aktivitetin: "Rekonstruimi i rrugëve Holgen Petersen dhe Ulëzat" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-4245-521 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "ULPIANA" e datës 31.08.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rekonstruimi i rrugëve Holgen Petersen dhe Ulëzat" dhe me Nr.616 18 4245 521, Nr. Brendshëm 616 18 070 521 kundër Njoftimit për Anulim të aktivitetit të prokurimit të AK –së, të datës 31.08.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për anulim të aktivitetit i publikuar me datë: 31.08.2018;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Ulpiana" me datë 31.08.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rekonstruimi i rrugëve Holgen Petersen dhe Ulëzat" me Nr.616 18 4245 521 Nr. Brendshëm 616 18 070 521". Autoriteti Kontraktues, me datë 03.09.2018 dhe 04.09.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Pretendimet se tenderuesi ka dhënë sqarime të mjaftueshme idhur me çmimet jonormalisht të ulta janë plotësisht të pa bazuara, pasi që kërkesat për sqarime janë bërë në harmoni me dispozitat ligjore, ndërsa sqarimet e dhëna nga i njëjti janë vetëm deklarime të pa bazuara. Sa janë sqarimet e dhëna joserioze dhe të pa argumentuara mund të pasqyrohet me sqarimin se fraksionet që duhet të jenë nga separacioni do të siguroj në kodrat e Hajvalisë apo sqarimin tjetër se sasi të janë të vogla, deponinë do ta siguroj në afërsi (që rezultojnë si deponi e egër) etj.


Bazuar në këtë kam konstatuar se vendimi i komisionit për mospranimin e sqarimeve tuaja është i drejtë.

Bazuar edhe në faktin se tenderuesit tjerë poashtu janë të pa përgjegjshëm për arsyet e përmendura në Vendimin për anulim, i njëjti vërtetohet edhe me këtë Vendim sipas kërkesës tuaj.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në të gjitha konstatimet e paraqitura më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit